



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:075360

Datë: 11.09.2019

Numri i dokumentit: 00509816

P. nr. 91/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.G., K.Gjakovë, për shkak të veprës penale, vjedhje e pyllit nga neni 358 par 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP.nr.1605/18 të datës 29.01.2019, në shqyrtimin gjyqësor, të mbajtur më datë **11.09.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj dhe të akuzuarit N.G., te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I

I akuzuari **N.G.**, K Gjakovë, i biri i M. dhe i nënës F. e gjinisë M., data e lindjes..., ka te kryer shkollën e mesme, bukëpjekës, i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i 3 fëmijëve, numer personal...

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

- **me dt. 06.10.2018, rreth orës 07:20 min**, në pyjet publike, në vendin e quajtur “P. i V.”, R.E.P.P., është zënë nga rojtari i pyjeve S.B., duke transportuar drunjtë me automjetin e tij të tipit kombibus, me ngjyrë të portokalltë, pa targa regjistrimi, ashtu që në bagazhin e mjetit të tij kishte ngarkuar drunjtë të llojit “ah”, me diametër mesatar 1.30m dhe me vëllim të përgjithshëm prej 2.30m³, me ç’rast me këtë veprim të dëmtuarës D. per B.,P., dhe Zh.R.-A.P.K .në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm material në vlerë diku rreth 439.80 Euro.

-me çka ka kryer vepër penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par 1 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,41,43,46,73 të KPRK-ës, dhe nenit 358 par 1të KPRK-së dhe nenit 365 te KPPK-së te pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumën prej **200(dyqind)euro**, të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund te ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)**

E dëmtuara, për të realizuar kërkesën e vet pasurore -juridike udhëzohen në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe atë në emër te paushallit gjyqësor shumë prej **30.00 euro** ne afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1605/18 të datës 29.01.2019, e ka akuzuar të akuzuarin N.G., K. Gjakovë, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 11.09.2019, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Anton Hasanaj, mbeti ne tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari N.G., gjatë shqyrtimit fillestar, duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer për shkak te gjendjes se dobët ekonomike, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm, mirëpo e kontestojë lartasin e demit të konstatuar nga e dëmtuara me qene se sasia e drurëve të konstatuar nga ana e rojës se pyllit nuk ka qene ashtu siç është deklaruar meqenëse e njëjta as qe është matur dhe drunjtë kanë qene te përziëra e po ashtu nga vet fakti kjo sasi e drurëve nuk mund të bartet me kombi bus, siç ka konstatuar roja e pyllit, andaj, i propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimi i shprehur në gjykatë për veprën e kryer, premtimi se në të ardhmen nuk do të përsëritet një gjë e tillë, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se me parë nuk kam ra ndesh me ligjin të më shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes, por meqenëse në shkresat e nuk kemi ekspertizë mbi sasinë e druve të prerë i propozojë gjykatës që e dëmtuara të udhëzohet në kontest civil.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari N.G.:**me dt. 06.10.2018, rreth orës 07:20 min**, në pyjet publike, në vendin e quajtur “P. i V.”, R.E.P.P., është zënë nga rojtari i pyjeve S.B., duke transportuar drunjtë me automjetin e tij të tipit kombi bus, me ngjyrë të portokalltë, pa targa regjistrimi, ashtu që në bagazhin e mjetit të tij kishte ngarkuar drunjtë të llojit “ah”, me diametër mesatar 1.30m dhe me vëllim të përgjithshëm prej 2.30m³, me ç ’rast me këtë veprim të dëmtuarës D. per B.,P., dhe Zh.R.-A.P.K.në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm material në vlerë diku rreth 439.80 Euro.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza

vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i pandehuri, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, pendimin e tij të shprehur për veprën e kryer, faktin se i akuzuari më parë nuk ka qene i dënuar, gjendja e dobët ekonomike, të cilat rrethana ndikuan që Gjkata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Gjkata të akuzuarit i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 200 Euro, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 të KPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë konform nenit 463 te KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 91/19 më datë 11.09.2019.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.